



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA**

Nr. 980/prot.
2

Tiranë, më 25/08 2025

Vendim nr. 48 datë 25.08.2025

Për ringritjen e njësisë studimore të përkohshme “Instituti Kombëtar i Fizikës (IKF)”

Bazuar në nenin 4 dhe nenin 19 të ligjit 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 44 të Statutit të Akademisë së Shkencave; pas shqyrtimit të kërkesës së drejtueses së njësisë “Instituti Kombëtar Virtual i Fizikës (IKF)” për zgjatjen e mandatit 2-vjeçar, njohjen e raportit të veprimtarisë të kësaj njësie për periudhën qershor 2023 – qershor 2025, dhe propozimet për veprimtarinë kërkimore shkencore për vitet 2025-2027 (bashkëngjitur); konsultimit me komisionin e përhershëm të fizikë-kimisë dhe miratimin nga anëtarët e Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike (bashkëlidhur), Kryesia e Akademisë së Shkencave në mbledhjen e saj të datës _____.2025,

Vendosi:

1. Të ringrejë njësinë kërkimore të përkohshme “Instituti Kombëtar i Fizikës (IKF)”, e cila ka vepruar deri më datë 20.06.2025 sipas vendimit të Kryesisë nr. 30, datë 20.06.2023, edhe për dy vjet të tjera.
2. IKF të vazhdojë të veprojë në përputhje me dokumentet bazë të themelimit: akti i krijimit dhe i caktimit të bordit drejtues miratuar me VKA nr. 42 datë 5.7.2021 dhe rregullorja e miratuar me VKA 56 date 16.9.2021. Detyrën e koordinatorit të vijoje ta kryejë prof. asoc. Olta Çakaj sipas vendimit të Kryesisë nr. 51, datë 3.8.2021.
3. Propozimet e paraqitura nga akad. Mimoza Hafizi, programuar edhe ne programin vjetor të ASH-së, miratuar me vendim të Asamblesë nr. 12 datë 28.02.2025, të shërbejnë si plan pune për vitin 2025.
4. Brenda muajit shtator 2025 bordi drejtues të paraqesë programin përfundimtar për dy vitet në vazhdim (shtator 2025 – shtator 2027).

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: sekretari shkencor, kryetari i SSHNT, drejtuesi i njësisë, kancelari, sektori i buxhetit dhe financës dhe specialistja e burimeve njerëzore dhe juriste.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Skënder Gjinushi

KRYETAR

